



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 14 maj 2026
Nr. ref.: AGJ3070/26

AKTGJYKIM

në

rastin nr. KI337/25

Parashtrues

Neshet Kërleshi

Vlerësim i kushtetutshmërisë së kohëzgjatjes së procedurës në lëndën [SCC-09-0016] në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Nexhmi Rexhepi, kryetar
Safet Hoxha, zëvendëskryetar
Bajram Ljatifi, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare
Enver Peci, gjyqtar dhe
Jeton Bytyqi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

- Kërkesa është parashtruar nga Neshet Kërleshi, me vendbanim në Gjakovë (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), i përfaqësuar nga Ylli Bokshi, avokat në Komunën e Gjakovës.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston kushtetutshmërinë e kohëzgjatjes së procedurës gjyqësore që aktualisht është duke u zhvilluar në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme: DHPGJS) në lidhje me lëndën [SCC-09-0016].

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së kohëzgjatjes së procedurës me pretendimin se mosvendosja e gjykatave të rregullta lidhur me rastin e parashtruesit të kërkesës, cenon të drejtat e tij të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) dhe nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat dhe Liritë themelore të Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 (Procedimi i kërkesës) dhe 47 (Kërkesa Individuale) të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregullin 25 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) të Rregullores së punës nr. 01/2023 së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 24 tetor 2025, parashtruesi i kërkesës përmes postës elektronike e dorëzoi kërkesën e tij në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 12 nëntor 2025, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin [nr. GJR. KI337/25] caktoi gjyqtarin Jeton Bytyqi gjyqtar raportues, ndërsa me vendimin [nr. KSH. KI337/25] Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Nexhmi Rexhepi (kryesues), Safet Hoxha dhe Bajram Ljatifi (anëtarë).
7. Më 24 nëntor 2025, Gjykata njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ai që të dorëzojë në Gjykatë Aktvendimin [SCC-09-0016] të DHPGJS-së të 7 tetorit 2025. Në të njëjtën ditë, Gjykata e njoftoi gjithashtu DHPGJS-në për regjistrimin e kërkesës dhe të njëjtës i dërgoi një kopje të kërkesës.
8. Më 27 nëntor 2025, parashtruesi i kërkesës përmes postës elektronike dorëzoi në Gjykatë aktvendimin e kërkuar nga Gjykata më 24 nëntor 2025.
9. Më 15 janar 2026, Gjykata i dërgoi një shkresë DHPGJS-së dhe kërkoi nga ajo që të informojë Gjykatën se: (i) në cilën fazë të procedurës gjendet aktualisht shqyrtimi i padisë së parashtruesit të kërkesës; dhe (ii) cilat hapa janë ndërmarrë për zgjidhjen e saj nga regjistrimi i saj para DHPGJS-së.
10. Më 22 janar 2026, DHPGJS-ja dorëzoi në Gjykatë përgjigjet e saj lidhur me shkresën e 15 janarit 2026.

11. Më 28 prill 2026, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës pranueshmërinë e kërkesës. Në të njëjtën ditë, Gjykata njëzëri vendosi: (i) ta deklarojë kërkesën e pranueshme; (ii) të konstatojë se ka pasur shkelje të paragrafit 2 të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe paragrafit 1 të nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, përkitazi me të drejtën për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm brenda një afati të arsyeshëm kohor; (iii) të urdhërojë Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme që jo më larg se 29 korrik 2026, ta informojë Gjykatën Kushtetuese lidhur me masat e ndërmarra për zbatimin e këtij Aktgjykimi, në pajtim me paragrafin 5 të rregullit 60 (Zbatimi i vendimeve) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese.

Përmbledhje a fakteve

12. Në bazë të shkresave të lëndës rezulton se parashtruesi i kërkesës më 12 dhjetor 2006, kishte parashtruar padi përkitazi me të drejtat pronësore në paluajtshmërinë në ngastrën kadastrale nr. 4429 (vreshtë, 0.12.05 ha) sipas Fp.nr.948 KK Gjakovë-jashtë qytetit (në tekstin e mëtejme: ngastra kontestuese) kundër SH.A. Kombinati Bujqësor Industrial “Ereniku” Gjakovë (në tekstin e mëtejme: KBI “Ereniku”), në Gjykatën Komunale në Gjakovë (në tekstin e mëtejme: Gjykata Komunale). Parashtruesi i kërkesës, përmes padisë kërkoi nga Gjykata Komunale që të zgjidhet (anulohet) kontrata për ndërrimin e patundshmërive e vitit 1959, e lidhur ndërmjet të ndjerit Bajram Kërleshi (B. K.), si paraardhës i parashtruesit të kërkesës dhe Ndërmarrjes vreshtare dhe pemëtare “Lugbunari” në Gjakovë, si paraardhëse juridike e KBI “Ereniku”, me të cilën ishte bërë ndërrimi me ngastrën kontestuese, duke kërkuar që kjo kontratë të shpallet e zgjidhur, dhe ngastra kontestuese, t’i kthehet në posedim të lirë dhe të qetë parashtruesit të kërkesës.
13. Në një datë të paspecifikuar, Gjykata Komunale e shpalli veten si jokompetenete për gjykimin e çështjes në fjalë dhe lëndën ia përcolli DHPGJS-së.
14. Më 24 prill 2009, parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesë në DHPGJS për lirim nga taksa gjyqësore në DHPGJS.
15. Më 7 tetor 2025, DHPGJS përmes Aktvendimit [SCC-09-0016] refuzoi kërkesën e parashtruesit të kërkesës për lirim nga pagimi i taksës gjyqësore.
16. Më 21 tetor 2025, parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë në Kolegjin e Apelit të DHPGJS-së, kundër Aktvendimit [SCC-09-0016] të 7 tetorit 2025 të DHPGJS-së. Deri më 22 janar 2026, kur Gjykata pranoi informata nga DHPGJS-ja, Kolegji i Apelit ende nuk kishte vendosur lidhur me ankesën e parashtruesit të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

17. Parashtruesi i kërkesës pretendon se kohëzgjatja e procedurës në rastin [SCC-09-0016], që është duke u shqyrtuar në DHPGJS ka cenuar të drejtën e tij të garantuar me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, dhe nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.
18. Lidhur me këtë, ai pretendon se procedura gjyqësore, edhe pse ishte iniciuar që në vitin 2006, përmes padisë drejtuar Gjykatës Komunale, e cila ishte shpallur si jokopetente për vendosjen e rastit, dhe të njëjtin e kishte përcjellë në DHPGJS për vendosje, ende nuk është vendosur nga gjykatat e rregullta, përkatësisht, nuk është marrë asnjë veprim nga ana e gjykatës kompetente për zgjidhjen e rastit në merita.

19. Parashtruesi i kërkesës thekson se për më shumë se 16 (gjashtëmbëdhjetë) vjet, padia në fjalë ka mbetur plotësisht e patrajtuar nga gjykata kompetente. Gjatë kësaj periudhe nuk është caktuar asnjë seancë dëgjimore, nuk është zhvilluar shqyrtimi i provave, nuk u është kërkuar palëve të paraqesin qëndrime shtesë dhe nuk është marrë asnjë vendim, qoftë të ndërmjetëm apo përfundimtar. Pra, sipas tij, çdo përpjekje për të marrë informacion mbi ecurinë e çështjes, përmes interesimit personal dhe komunikimeve me administratën gjyqësore, ka mbetur pa përgjigje konkrete ose pa sqarim të arsyeshëm për vonesën. Kjo situatë përbën një zvarritje të pajustificuar dhe të tepruar të procedurës, në kundërshtim me standardet e procesit të rregullt dhe të drejtë gjyqësor të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së, i cili garanton të drejtën për një gjykim të drejtë dhe brenda një afati të arsyeshëm.
20. Tutje, parashtruesi i kërkesës thekson se në praktikën e zakonshme gjyqësore, çështjet civile të ngjashme përfundojnë brenda 2 (dy) deri në 5 (pesë) vite, edhe kur janë komplekse, ndërsa në këtë rast, vonesa mbi një dekadë pa asnjë veprim procedural tejkalon çdo kufi të arsyeshëm dhe përbën shkelje serioze të së drejtës për qasje efektive në drejtësi. Mosveprimi i zgjatur i gjykatës ka shkaktuar pasoja të rënda personale, ekonomike dhe juridike për paditësin, duke krijuar pasiguri të vazhdueshme mbi të drejtën e tij pronësore dhe duke penguar çdo zhvillim apo disponim me pronën.
21. Parashtruesi i kërkesës më tej pretendon se në rastin konkret, çështja nuk paraqet kompleksitet të jashtëzakonshëm dhe ai nuk ka shkaktuar asnjë vonesë, ndërsa autoritetet gjyqësore nuk kanë ndërmarrë asnjë veprim procedural për mbi 10 (dhjetë) vite. Më tej, ai i referohet praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, përkatësisht rasteve *Boddaert kundër Belgium* dhe *Zimmermann dhe Steiner kundër Zvicrrës*, ku sipas tij, është theksuar se zvarritjet shumëvjeçare përbëjnë shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së dhe se shteti ka përgjegjësi të sigurojë funksionimin efikas të sistemit gjyqësor. Parashtruesi i kërkesës po ashtu i përmend edhe rastet se Gjkata ka gjetur shkelje për shkak të tejzgjatjes së procedurës gjyqësore, përkatësisht rastet KIO6/21, parashtrues *Dragan Mihajloviq* dhe KIO6/23, parashtrues *Mejreme Qehaja Rexha*.
22. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu kërkon që të konstatohet shkelja dhe të akordohet kompensim për dëm jomaterial në shumën 10,000.00 (dhjetëmijë) euro për shkak të vuajtjeve shpirtërore të shkaktuara nga mohimi i së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm.
23. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që: (i) të deklarojë kërkesën e pranueshme; (ii) të konstatojë se ka pasur shkelje të paragrafit 2 të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNJ-së; (iii) që Republika e Kosovës t’ia kompensoj parashtruesit të kësaj kërkesë shumën prej 10,000.00 (dhjetëmijë) euro, “me kamatë dhe shpenzime në afatin prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi”.

Komentet e pranuar nga DHPGJS-ja

24. DHPGJS-ja, në përgjigjen e saj drejtuar Gjykatës, thekson se kohëzgjatja “e procedurave rreth lëndëve, përfshirë edhe këtë lëndë fillimisht ka të bëjë kryesisht me ndërrimet e gjyqtarëve dhe zyrtarëve ligjorë të caktuar për lëndën”. DHPGJS po ashtu sqaron se “në veçanti gjyqtarja e çështjes lëndën në fjalë e ka pranuar në fund të shkurtit 2025 dhe njëherit ju njoftojmë se ka në pritje në numër të përafert diku rreth 700 (shtatë qindtë lëndë), e që paraqet një numër jashtëzakonisht të madh të lëndëve e që presin për tu vendosur”.

25. DHPGJ më tej shton se gjyqtarja e çështjes “ka ndërmarr të gjitha veprimet procedurale, e që me datën 07.10.2025, ka dërguar Urdhrin për Përgjigjen në padi te e paditura si dhe me datën 07.10.2025, me Aktvendim ka vendosur për kërkesën për lirim nga taksa.”
26. Më tej, DHPGJS thekson se parashtuesi i kërkesës “me datën 27.10.2025, ka apeluar këtë vendim në Kolegjin e Apelit të DHPGJS-se e që pritet nga ky i fundit të vendos lidhur me këtë ankesë dhe pas përfundimit të vendimmarrës së Kolegjit të Apelit, gjykata e shkallës parë do të ketë në konsideratë lëndën ku do të ndërmarr të gjitha veprimet për procedim të mëtejshme duke i ftuar palët në seancë dhe duke shqyrtuar lëndën sipas dispozitave në fuqi”.

Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore

Kushtetuta e Republikës së Kosovës Neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

[...]

2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.”

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut Neni 6 (E drejta për një proces të rregullt)

“1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. [...]”

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

27. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtuesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me Kushtetutë, të parapara me Ligj dhe të specifikuara më tej me Rregullore të punës.
28. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:
- “1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.
[...]
7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.
29. Gjykata i referohet më tej neneve 47 (Kërkesa individuale), 48 (Saktësimi i kërkesës) dhe 49 (Afatet) të Ligjit, të cilët parashohin:

Neni 47 (Kërkesa individuale)

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individ i mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

Neni 48
(Saktësimi i kërkesës)

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

Neni 49
(Afatet)

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. [...]

30. Sa i përket përmbushjes së kriterëve të lartcekura, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar që konteston kohëzgjatjen e procedurës lidhur me lëndën [SCC-09-0016] e cila ndodhet në shqyrtim në DHPGJS. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu ka qartësuar të drejtat dhe liritë themelore që pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit. Në lidhje me afatin për paraqitjen e kërkesës, Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës konteston kohëzgjatjen e procedurës gjyqësore përkitazi me ngastrën kontestuese, të filluar përmes padisë në vitin 2006, e cila ende nuk ka përfunduar, pasi padia ka kaluar për shqyrtim nga Gjykata Komunale në DHPGJS. Gjykata, duke marrë parasysh natyrën e pretendimeve, përkatësisht kohëzgjatjen e procedurës, rikujton se në rrethana të tilla nuk kërkohet përmbushja e kushteve të parashikuara me nenin 49 (Afatet) të Ligjit, përkatësisht kushti për paraqitjen e kërkesës brenda katër (4) muajve, pasi lënda është ende në zhvillim e sipër.
31. Përveç kushteve të parashikuara me Ligj, Gjykata më tej shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës ka përmbushur kushtet e pranueshmërisë të përcaktuara në paragrafin (2) të rregullit 34 (Kriteret e Pranueshmërisë) të Rregullores së punës, të cilat përcaktojnë që:

Rregulli 34
(Kriteret e Pranueshmërisë)

*“(1) Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të pranueshme nëse:
[...]*

(d) Kërkesa qartëson saktësisht dhe në mënyrë adekuate paraqet faktet dhe pretendimet për shkelje të të drejtave apo dispozitave kushtetuese.

(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, kur parashtruesi/ja nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij/saj”.

32. Gjykata thekson se kërkesa përmbush kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në paragrafin 1 të rregullit 34 (Kriteret e Pranueshmërisë) të Rregullores së punës dhe se nuk mund të shpallet e papranueshme bazuar në kushtet e përcaktuara nga paragrafi 2 i rregullit 34 të Rregullores së punës. Përveç kësaj dhe përfundimisht, Gjykata

thekson se kërkesa nuk mund të deklarohej e papranueshme në asnjë bazë tjetër. Prandaj, ajo duhet të deklarohej e pranueshme dhe të vlerësohen meritat e saj.

Meritat e kërkesës

33. Gjykata rikujton se bazuar në rrethanat e rastit konkret rezulton se më 12 dhjetor 2006, parashtruesi i kërkesës paraqiti padi përkitazi me ngastrat kontestuese ndaj KBI “Ereniku”. Gjykata Komunale u shpall jokompetente për shqyrtimin e çështjes dhe lëndën ia përcolli DHPGJS-së. Më 24 prill 2009, parashtruesi i kërkesës kërkoj nga DHPGJS-ja lirim nga pagesa e taksës gjyqësore, mirëpo kjo kërkesë u refuzua me Aktvendimin [SCC-09-0016] të 7 tetorit 2025. Si rrjedhojë, më 21 tetor 2025, ai paraqiti ankesë kundër këtij aktvendimi pranë Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së. Bazuar në shkresat e lëndës, Kolegji i Apelit i DHPGJS-së ende nuk ka vendosur lidhur me ankesën e parashtruesit të kërkesës.
34. Në lidhje me këtë, parashtruesi i kërkesës pretendon se, si rezultat i kohëzgjatjes së paarsyeshme të procedurës gjyqësore sipas kërkesëpadisë që ende nuk ka marrë zgjidhje përfundimtare nga DHPGJS-ja, i është shkelur e drejta e tij për një gjykim brenda një afati të arsyeshëm, siç garantohet me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së. Prandaj, ai kërkon nga Gjykata “*të konstatojë se ka pasur shkelje të paragrafit 2 të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNJ-së*”.
35. Gjykata në vazhdim do të trajtojë këtë pretendim të parashtruesit të kërkesës në bazë të parimeve të përgjithshme të përcaktuara përmes praktikës së saj gjyqësore, por edhe asaj të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.

(i) Parimet e përgjithshme përkitazi me të drejtën për gjykim brenda një afati të arsyeshëm

36. Gjykata rikujton se, paragrafi 2 i nenit 31 të Kushtetutës përcakton se: “Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme [...]”.
37. Ndërsa, paragrafi 1 i nenit 6 të KEDNJ-së përcakton se: “Çdo person ka të drejtë që [...] të dëgjohet [...] brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë [...], e cila do të vendosë [...] në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij [...] civile [...]”.
38. Prandaj, bazuar në dispozitat e lartcekura, e drejta për një vendim brenda një afati të arsyeshëm është pjesë përbërëse e të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së.
39. Lidhur me këtë, Gjykata tashmë ka një praktikë relativisht të konsoliduar gjyqësore që përfshin, por nuk kufizohet në rastet: (i) [KI64/23](#), parashtruese *Mejrem Qehaja Rexha*, Aktgjykim i 31 gushtit 2023; (ii) [KIO6/21](#), parashtrues *Dragan Mihajlović*, Aktgjykim i 22 dhjetorit 2022; (iii) [KI19/21](#), parashtrues *Sadik Pllana*, Aktgjykim i 18 korrikut 2022; (iii) [KI142/23](#), parashtrues *Fadil Berisha*, Aktgjykim i 12 shkurtit 2025. Në praktikën e saj gjyqësore, Gjykata ka afirmuar parimet e vendosura nga GJENDJ-ja, duke përfshirë rastet: (i) [Poiss kundër Austrisë](#), nr. 9816/82, Aktgjykim i 23 prillit 1987; (ii) [Abdoella kundër Holandës](#), nr. 12728/87, Aktgjykim i 25 nëntorit 1992; (iii) [Comingersoll S.A. kundër Portugalisë](#), nr. 35382/97, Aktgjykim i 6 prillit 2000; (iv) [Scordino kundër Italisë](#) (nr.1), nr. 36813, Aktgjykim i 29 marsit 2006; (v)

[Frydlender kundër Francës](#), nr. 30979/96, Aktgjykim i 27 qershorit 2000; (vi) [Sürmeli kundër Gjermanisë](#), nr. 75529/01, Aktgjykim i 8 qershorit 2006; (vii) [Famullia Katolike Greke Lupeni dhe të tjerët kundër Rumanisë](#), nr. 76943/11, Aktgjykim i 29 nëntorit 2006; dhe (viii) [Nicolae Virgiliu Tănase kundër Rumanisë](#), nr. 41720/13, Aktgjykim i 25 qershorit 2019.

40. Bazuar në praktikën e lartcekur gjyqësore, rezulton se: (i) përlllogaritja e kohëzgjatjes së procedurave gjyqësore fillon nga momenti kur gjykata kompetente vihet në lëvizje me kërkesë të palës për vendosjen e një të drejte apo interesi legjitim të pretenduar; (ii) gjatë llogaritjes merret për bazë procedura në tërësinë e saj, përfshirë këtu edhe procedurat e apelimit dhe procedurën e ekzekutimit të një vendimi gjyqësor përfundimtar; (iii) arsyeshmëria e zgjatjes së një procesi gjyqësor duhet të vlerësohet duke u bazuar në rrethanat përkatëse dhe veçoritë e secilit rast; dhe se (iv) shteti është i detyruar që të organizojë sistemin e drejtësisë në mënyrë të tillë që gjykatat të mund të garantojnë të drejtat e secilit për një vendim përfundimtar gjyqësor, në lidhje me të drejtat dhe obligimet civile të tyre brenda një afati të arsyeshëm kohor (shih rastet e GJEDNJ-së: [Poiss kundër Austrisë](#), cituar më lart, paragrafi 50; [Comingersoll kundër Portugalisë](#), cituar më lart, paragrafi 24; dhe [Famullia Katolike Greke Lupeni dhe të tjerët kundër Rumanisë](#), cituar më lart, paragrafi 142; dhe rastet e Gjykatës [KIO6/21](#), cituar më lart, paragrafët 50-75; dhe [KI19/21](#), cituar më lart, paragrafi 82; dhe [KI142/23](#), cituar më lart, paragrafi 47).
41. Për më tepër, sipas praktikës gjyqësore të Gjykatës dhe asaj të GJEDNJ-së, arsyeshmëria e kohëzgjatjes së procedurës gjyqësore matet duke u bazuar në këto kritere kryesore: (i) kompleksiteti i rastit, (ii) sjellja e palës, (iii) sjellja e autoriteteve shtetërore, dhe (iv) rëndësia e asaj se çfarë është në rrezik për palën në kontestin gjyqësor (shih rastin e GJEDNJ-së: [Surmeli kundër Gjermanisë](#), cituar më lart, paragrafi 128; si dhe rastet e Gjykatës [KI64/23](#), cituar më lart, paragrafi 65 dhe [KI142/23](#), cituar më lart, paragrafi 48).
42. Përkitazi me (i) kompleksitetin e rastit, kjo mund të ndërlidhet me çështjet faktike dhe ligjore; me përfshirjen e disa palëve në procedurë; me një numër të caktuar provash që duhet trajtuar para gjykatave të rregullta; apo edhe me një numër më të madh të raporteve të ekspertëve që kërkohen. Thënë këtë, edhe në rastet kur një procedurë nuk është komplekse, mungesa e qartësisë dhe parashikueshmërisë në legjislacionin vendor mund të vështirësojë zgjidhjen e rastit dhe të kontribuojë në kohëzgjatjen e procedurës (shih në mënyrë të ngjashme rastin e Gjykatës: [KI64/23](#), cituar më lart, paragrafët 66-67; [KI142/23](#), cituar më lart, paragrafi 49; dhe rastet e GJEDNJ-së: [Papachelas kundër Greqisë](#), nr. 31423/96, Aktgjykim i 25 marsit 1999; dhe [Nicolae Virgiliu Tanase kundër Rumanisë](#), cituar më lart, paragrafi 210).
43. Përkitazi me (ii) sjelljen e palës në procedurë, nuk kërkohet nga pala bashkëpunim aktiv me autoritetet gjyqësore, e as nuk mund të fajësohet pala për përdorimin e mjeteve juridike sipas legjislacionit në fuqi, megjithatë, autoritetet shtetërore nuk mund të mbahen përgjegjëse nëse këto veprime ndikojnë në kohëzgjatjen e procedurës; nga pala kërkohet vetëm të jetë e vëmendshme në ndërmarrjen e hapave proceduralë dhe të mos përdorë taktika për ta shtyrë procedurën në favor të tij; dhe se vetëm vonesat që i atribuohen shtetit mund të ndikojnë në përcaktimin nëse procedurat nuk kishin përfunduar brenda një afati të arsyeshëm kohor. Disa shembuj që kanë të bëjnë me sjelljen e palës janë: mungesa e vullnetit për të dorëzuar shkresat, e cila mund të ndikojë në ngadalësimin e procedurës; ndryshimi i shpeshtë i avokatit; përpjekjet për të arritur marrëveshje jashtëgjyqësore; nisja e procedurës përpara gjykatës që nuk ka juridiksion për çështjen; mungesa e kujdesit në ndërmarrjen e hapave proceduralë (shih rastet e GJEDNJ-së: [Erkner dhe Hofauer kundër Austrisë](#), cituar më lart, paragrafi 68; dhe [Union AlemntariaSanders S.A kundër Spanjës](#), nr.

11681/85, Aktgjykim i 7 korrikut 1989, paragrafi 35). Sjellja e palës përbën një fakt objektiv që nuk mund t'u atribuohet autoriteteve shtetërore dhe duhet të merret parasysh gjatë vlerësimit nëse procedura ishte kryer brenda një periudhe të arsyeshme kohore (shih rastin e Gjykatës: [KI64/23](#), cituar më lart, paragrafët 68-70; dhe [KI142/23](#), cituar më lart, paragrafi 50).

44. Sa i përket (iii) sjelljes së autoriteteve kompetente, shteti mban përgjegjësi për të gjitha autoritetet, dhe jo vetëm për sistemin gjyqësor, por edhe për sjelljet e institucioneve publike; gjatë vlerësimit nëse procedura është kryer brenda një afati të arsyeshëm kohor, gjykata duhet ta vlerësojë procedurën në tërësi; përkundër që shteti mund të jetë përgjegjës për defekte të caktuara procedurale, megjithatë, kjo nuk e përjashton mundësinë që të ketë vepruar në përputhje me detyrat e veta për ta shqyrtuar rastin në mënyrë të shpejtë; shkaktimi i vonësive nga ndërrimi i shpeshhtë i gjyqtarëve nuk e shmang përgjegjësinë e shtetit për kryerjen e procedurave brenda afateve të arsyeshme kohore; mbingarkesa kronike e lëndëve nuk mund të shërbejë si arsye për stërzgjatjen e procedurave; dhe se gjykatat nuk mund të lejojnë që rasti të bartet pafundësisht prej një instance gjyqësore të tjetra (shih rastet [KI64/23](#), cituar më lart, paragrafët 71-73; dhe [KI142/23](#), cituar më lart, paragrafi 51).
45. Sa i përket (iv) rëndësisë së asaj se çfarë është në rrezik për palën në kontest, ekzistojnë kategori të caktuara të rasteve të cilat, për nga natyra e tyre, duhet të trajtohen me kujdes të veçantë dhe të vendosen me shpejtësi më të madhe. Shembuj të këtyre kategorive të rasteve përfshijnë: rastet që ndërlidhen me statusin; rastet që ndërlidhen me kujdestarinë e fëmijëve; me raportin prind-fëmijë; me kujdesin e gjyshërve ndaj fëmijëve, kur këta të fundit kanë mbetur pa kujdesin e prindërve; përgjegjësinë e prindërve dhe të drejtat e kontaktit me fëmijët; rastet që ndërlidhen me kontestet nga marrëdhënia e punës; ankesa kundër largimit nga puna; suspendimi nga puna; transferimi; rikthimi në punë; rastet që ndërlidhen me persona të cilët vuajnë nga “*sëmundje të pashërueshme*” dhe kanë “*pritje të reduktuar të jetëgjatësisë*”; rastet që lidhen me pretendimet për ushtrim të dhunës nga zyrtarët policorë; dhe rastet kur mund të rrezikohet e drejta e edukimit. Disa raste të tjera nuk kërkojnë vëmendje të shtuar, p.sh. rastet që lidhen me kompensimin e dëmit të shkaktuar në aksidente rrugore, apo rastet që kanë të bëjnë me ndarjen e trashëgimisë ndërmjet trashëgimtarëve të personit të vdekur (shih rastet e Gjykatës: [KI64/23](#), cituar më lart, paragrafi 74; dhe [KI142/23](#), cituar më lart, paragrafi 52).

(ii) Aplikimi i parimeve të lartcekura në rrethanat e rastit konkret

Periudha që do të merret parasysh

46. Gjykata rikujton se më 12 dhjetor 2006 parashtruesi i kërkesës paraqiti në Gjykatën Komunale padinë ndaj KBI “*Ereniku*”. Gjykata Komunale u shpall jokompetente për shqyrtimin e çështjes dhe lëndën ia përcolli DHPGJS-së. Më 24 prill 2009, parashtruesi i kërkesës kërkoj nga DHPGJS-ja lirimin nga pagesa e taksës gjyqësore, mirëpo kjo kërkesë u refuzua me Aktvendimin [SCC-09-0016] të 7 tetorit 2025. Si rrjedhojë, më 21 tetor 2025, ai paraqiti ankesë kundër këtij aktvendimi pranë Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së. Në këto rrethana, Gjykata vlerëson se rasti i parashtruesit të kërkesës, përkitazi me çështjen që është objekt i shqyrtimit para Gjykatës, ka filluar më 12 dhjetor 2006, ka vazhduar të shqyrtohet edhe pas 15 qershorit 2008, kur Kushtetuta ka hyrë në fuqi, dhe deri më 22 janar 2026, kur Gjykata ka pranuar informata nga DHPGJS-ja, përfshinë periudhën më tepër se gjashtëmbëdhjetë (16) vite, dhe ende pret të zgjidhet në merita nga DHPGJS-ja. Rrjedhimisht, kjo është periudha që do të merret parasysh nga Gjykata.

47. Për të arritur një përfundim se a është zgjidhur rasti i parashtruesit të kërkesës brenda një afati të arsyeshëm, Gjykata më tej do të vlerësojë (i) ndërlikueshmërinë e rastit, (ii) sjelljen e palës, (iii) sjelljen e organeve shtetërore, si dhe (iv) rëndësinë e asaj që është në rrezik për palën në kontestin gjyqësor.

(i) Përkitazi me ndërlikueshmërinë e rastit

48. Gjykata vëren se rasti i parashtruesit të kërkesës ka të bëjë me çështje pronësore ku parashtruesi i kërkesës kërkoi prishjen e kontratës për ndërrimin e patundshmërive e vitit 1959, e lidhur ndërmjet të ndjerit B. K., si paraardhës i tij dhe Ndërmarrjes vreshtare dhe pemëtare “Lugbunari” në Gjakovë, si paraardhëse juridike e KBI “Ereniku”, dhe që ngastra kontestuese t’i kthehet parashtruesit të kërkesës.
49. Gjykata vëren se natyra e tij kërkon vlerësimin e shumë çështjeve faktike dhe ligjore, duke përfshirë vlerësimin e pronave në fjalë. Megjithatë, Gjykata vlerëson se, pavarësisht ekzistimit të një niveli të caktuar kompleksiteti të fakteve dhe provave, çështja nuk ka natyrë të tillë që të justifikojë një procedurë me kohëzgjatje të tillë. Përkundrazi, sipas parimeve të vendosura në praktikën e GJEDNJ-së edhe kur ekziston një kompleksitet i caktuar i rastit, një kohëzgjatje e tillë e procedurës tejkalon kufijtë e një afati të arsyeshëm dhe tregon mungesë efikasiteti dhe parashikueshmërie ligjore në veprimtarinë e gjykatave.

(ii) Sa i përket sjelljes së palës

50. Në lidhje me sjelljen e parashtruesit të kërkesës, Gjykata rikujton se nuk kërkohet nga pala që të bashkëpunojë në mënyrë aktive me organet gjyqësore, as nuk mund të konsiderohet përgjegjëse për përdorimin e mjeteve juridike të lejuara me ligj, siç janë ankesa dhe revizioni. Në rastin konkret, parashtruesi i kërkesës ka vepruar brenda të drejtave të tij ligjore, duke përdorur mekanizmat ligjorë në dispozicion për të mbrojtur interesat e tij dhe për të ushtruar të drejtën e tij në padi, kërkesën për lirim nga taksa gjyqësore dhe pastaj ankesën lidhur me të. Gjatë gjithë kohëzgjatjes së procedurës, që përfshin një periudhë më shumë se 16 (gjashtëmbëdhjetë) vite, nga dosja e lëndës dhe informatat e pranuar nuk rezulton se parashtruesi ka ndërmarrë ndonjë veprim me qëllim të shtyrjes së procedurës, as se sjellja e tij ka kontribuar në vonesat e krijuara.
51. Qëndron fakti që ai në vitin 2009 ka kërkuar nga DHPGJS lirin nga pagesa e taksës gjyqësore, dhe se parashtruesi i kërkesës, pas vendimit për refuzimin e kërkesës për lirim nga taksa gjyqësore, ka përdorur mjete juridike brenda afateve ligjore, për të kundërshtuar aktvendimin e DHPGJS-së për refuzimin e kërkesës për pagesë të taksës gjyqësore. Megjithatë, periudha nga viti 2009, deri në vitin 2025, kur ishte vendosur lidhur me kërkesën e tij për lirim nga taksa gjyqësore, nuk mund t’i atribuohet tërësisht parashtruesit të kërkesës, pasi DHPGJS-së i janë dashtë më tepër se 15 (pesëmbëdhjetë) vite për të vendosur në shkallë të parë, vetëm për kërkesën e tij për lirim nga taksa gjyqësore, pa ndërmarrë asnjë veprim për shqyrtimin e rastit në merita. Prandaj, Gjykata vlerëson se kohëzgjatja e tillë e procedurës lidhur me rastin e parashtruesit, nuk mund t’i atribuohet atij, pavarësisht faktit që ai ka përdorur mjetin juridik të përcaktuar me legjislacion në fuqi, për të kërkuar lirin nga taksa gjyqësore dhe ankesat përkatëse.

(iii) Sjellja e autoriteteve kompetente

52. Në lidhje me sjelljen e autoriteteve kompetente, Gjykata rikujton se shteti është përgjegjës për funksionimin efikas të të gjitha organeve të tij, duke përfshirë edhe sistemin gjyqësor, dhe se mbingarkesa kronike e gjykatave me raste, ndryshimet e shpeshta të gjyqtarëve ose vështirësitë administrative nuk mund të shërbejnë si

justifikim për zgjatjen e tepruar të procedurës gjyqësore. Në rastin konkret, procedura ka filluar në vitin 2006 në Gjykatën Komunale, dhe më pastaj kalimi i çështjes për gjykim ka kaluar në DHPGJS, pasi që Gjykata Komunale është shpallur si jokompetente për gjykimin e çështjes. DHPGJS më 7 tetor 2025 ka vendosur lidhur me refuzimin e kërkesës së parashtruesit të kërkesës për lirim nga taksa gjyqësore, por ende nuk ka vendosur lidhur me meritat e kërkesëpadisë. Lidhur me këtë, Gjykata vëren se DHPGJS-së i janë dashtë më tepër se 15 (pesëmbëdhjetë) vite për të vendosur vetëm për kërkesën e tij për lirim nga taksa gjyqësore, pa ndërmarrë asnjë veprim për shqyrtimin e rastit në merita.

53. Gjykata vëren se rasti tani ndodhet ende në DHPGJS, dhe se deri më 22 janar 2026, kur Gjykata është informuar nga DHPGJS, procedura lidhur me kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës ende nuk ka përfunduar në asnjërën shkallë gjyqësore. Prandaj, Gjykata vlerëson se shkaku kryesor i kohëzgjatjes së tepruar të procedurës në këtë rast është veprimi i ngadaltë dhe joefikas i DHPGJS-së, e cila nuk ka ndërmarrë masa adekuate për të zgjidhur çështjen brenda një afati të arsyeshëm, duke bërë që shteti të mos përmbushë detyrimin e tij për sigurimin e të drejtës efektive për gjykim brenda një afati të arsyeshëm sipas nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së.

(iv) Rëndësia e asaj çfarë është në rrezik për parashtruesin në kontest

54. Në lidhje me parimin e rëndësisë së asaj që është në rrezik për palën në kontest, Gjykata rikujton se sipas praktikës së konsoliduar të GJEDNJ-së, disa kategori të rasteve kërkojnë vëmendje të veçantë dhe urgjencë në veprimtarinë e gjykatave të brendshme, duke pasur parasysh ndikimin e drejtpërdrejtë që mund të ketë rezultati i procedurës mbi të drejtat themelore të palës.
55. Rasti i parashtruesit nuk mund të thuhet se i takon një kategorie të tillë. Megjithatë, Gjykata thekson se nuk mund të konsiderohet e arsyeshme një periudhë kaq e gjatë për zgjidhjen e një rasti të tillë, pavarësisht natyrës së rastit. Gjykata konsideron se tejzgjatja e trajtimit të çështjes në fjalë, është e papranueshme në rrethanat e rastit konkret dhe si e tillë është në kundërshtim të plotë me të drejtën e parashtruesit të kërkesës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm brenda një afati të arsyeshëm, ashtu siç garantohet nga paragrafi 2 i nenit 31 të Kushtetutës dhe paragrafi 1 i nenit 6 të KEDNJ-së.
56. Si përfundim, Gjykata marrë parasysh aplikimin kumulativ të kritereve të lartcekura, konstaton se (i) megjithëse rrethanat e rastit konkret ndërlidhen me kontest pronësor, nuk rezulton të jetë i një natyre aq të ndërlikuar sa që do të mund të justifikonte që procedura gjyqësore për zgjidhjen e lëndës përkatëse të mos përfundojë as pas kaq shumë kohe; (ii) parashtruesi i kërkesës nuk ka kontribuar në tejzgjatjen e procedurës përmes veprimeve të tij, pavarësisht se ai ka ndjekur hapat proceduralë për realizimin e të drejtës së tij, përfshirë kërkesën për lirim nga taksa gjyqësore; ndërsa (iii) DHPGJS-së as pas më shumë se 16 (gjashtëmbëdhjetë) vite nuk ka vendosur lidhur me kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës në asnjërën shkallë gjyqësore.
57. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se në rrethanat e parashtruesit të kërkesës, DHPGJS ka shkelur të drejtën e tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm brenda një afati të arsyeshëm, siç garantohet me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.
58. Në këtë kontekst, Gjykata thekson se, pas këtij aktgjykimi nëpërmjet të cilit konstatohet shkelja e nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, DHPGJS duhet të ndërmarrë të gjitha hapat e nevojshëm për ta përmbyllur çështjen

juridike të parashtruesit të kërkesës me prioritet, dinamikë të shtuar dhe brenda një afati sa më të shpejtë kohor, konform gjetjeve të këtij aktgjykimi.

59. Në lidhje me këtë, Gjykata thekson se përfundimi i lartcekur ekskluzivisht ka të bëjë me kohëzgjatjen e procedurave sa i përket shqyrtimit të rastit të parashtruesit të kërkesës dhe në asnjë mënyrë nuk paragjykon rezultatin e meritave të rastit të tij para gjykatave të rregullta.

Përkitazi me kërkesën për kompensim

60. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës ka kërkuar edhe që Republika e Kosovës t'ia kompensojë shumën prej 10,000.00 (dhjetëmijë) euro *“për shkak të dhimbjeve shpirtërore”*.
61. Gjykata ka ripërsëritur se nuk ka autorizime ligjore për caktimin e ndonjë lloji të kompensimit për rastet në të cilat konstaton shkelje të Kushtetutës dhe KEDNJ-së si pasojë e tejzgjatjes së procedurave gjyqësore (shih rastet [KI19/21](#), parashtrues *Sadik Pllana*, cituar më lart, paragrafi 115; [KIO6/21](#), cituar më lart, paragrafi 84; dhe [KI142/23](#), cituar më lart, paragrafi 68).
62. Gjykata përsërit se, në disa raste, gjetja e shkeljes kushtetuese paraqet një lloj të *“shpërblimit të drejtë”*, sidomos kur parashtruesi ka mundur të pësojë një dëm jo material. Megjithatë, individët mund të kërkojnë dëmshpërblim nga autoritetet publike në rast të konstatimit të shkeljes së të drejtave dhe lirive të tyre kushtetuese. Në rastet kur vetëm konstatimi i shkeljes nuk mjafton dhe kompensimi monetar është i domosdoshëm, individët kanë të drejtë të përdorin mjetet juridike në dispozicion për realizimin e të drejtave të tyre, përfshirë kompensimin e dëmit material dhe jomaterial pranë gjykatave të rregullta (shih, rastet e Gjykatës [KI113/21](#), parashtruese *Bukurije Haxhimurati*, Aktgjykim i 20 dhjetorit 2021, paragrafët 145-151; dhe [KIO6/21](#), parashtrues *Dragan Mihajlović*, cituar më lart, paragrafi 85).

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 të Kushtetutës, në nenet 20 dhe 47 të Ligjit dhe rregullin 48 (1) (a) të Rregullores së punës, në seancën e saj të mbajtur më 28 prill 2026, njëzëri:

VENDOS

- I. TË SHPALLË kërkesën të pranueshme;
- II. TË KONSTATOJË se ka pasur shkelje të paragrafit 2 të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe paragrafit 1 të nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, përkitazi me të drejtën për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm brenda një afati të arsyeshëm kohor;
- III. TË URDHËROJË Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme që jo më larg se 29 korrik 2026, ta informojë Gjykatën Kushtetuese lidhur me masat e ndërmarra për zbatimin e këtij Aktgjykimi, në pajtim me paragrafin 5 të rregullit 60 (Zbatimi i vendimeve) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese;
- IV. T'UA KUMTOJË këtë Aktgjykim palëve dhe, në pajtim me paragrafin 4 të nenit 20 të Ligjit, ta publikojë në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës;
- V. TË KONSTATOJË që ky Aktgjykim hyn në fuqi në ditën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, në pajtim me paragrafin 5 të nenit 20 të Ligjit.

Gjyqtari raportues

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Jeton Bytyqi

Nexhmi Rexhepi